

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Alban Beqiri, me sekretaren juridike Lendita Pajaziti në çështjen juridike të paditëses [REDACTED] nga [REDACTED], Rr.”[REDACTED]” nr.[REDACTED] të cilët me autorizim e përfaqëson av. [REDACTED], kundër të paditurve KS “[REDACTED]” me seli në [REDACTED] të cilën e përfaqëson me autorizim [REDACTED] si dhe KS “[REDACTED]”, me seli në Prishtinë, të cilin me autorizim e përfaqëson [REDACTED], në çështjen për kompensimin e dëmit, pas shqyrtimit kryesor të mbajtur, më datë 19.09.2016, në prezencën e paditëses të autorizuarit të saj si dhe në prezencën e përfaqësuesve të paditurve, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht kërkesë padia e paditëses [REDACTED] nga Ferizaj, Rr.”[REDACTED]” nr.[REDACTED], si e bazuar,

II. OBLIGOHEN të paditurat KS “[REDACTED]” dhe KS “[REDACTED]”, që të dytë me seli në Prishtinë që paditëses në emër të shpérblimit të dëmit material dhe jomaterial, në bazë të përgjegjësisë e paditura e parë 20%, kurse e paditura e dytë 80% t’ia paguajë paditësit në mënyrë solidare dhe atë

1. Në emër të dëmin jo material,

a, për dhimbje trupore-fizike shumën prej 3.000,00 €

b, për frikë të pësuar shumën prej 2.300,00 €,

c, për shëmtim trupor shumën prej 2.900,00 €

d, zvogëlimin e aktivitetit jetësor shumën prej 6.500,00 €

2. Në emër të dëmit material,

a, për kujdes nga personi i tretë shumën prej 100,00 €

b, për ushqimit të përforcuar shumën prej 200,oo€

d, për shpenzimet e mjekimit shumën prej 163,oo €

III. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesë padisë së paditëses mbi lartësitë e shumave të aprovuara në pikën një (**II.**) të dispozitivit dhe atë:

1. Në emër të dëmin jo material,

a, për dhimbje trupore-fizike shumën prej 3.000,oo€

b, për frikë të pësuar shumën prej 2.200,oo€

c, për shëmtim trupor shumën prej 3.100,oo €

d, në emër të zvogëlimit te aktivitetit jetësor shumën prej 5.500,oo€

IV. OBLIGOHEN të paditura që paditëses solidarisht që t’ia paguajnë shumat e cekura në pikën **II**, të dispozitivit, në shumë të përgjithshme prej 15.163 € (pesëmbëdhjetë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e tri euro), të gjitha me kamaten ligjore prej 8%, nga data 19.09.2016, deri në pagesën përfundimtare, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 1.469,20 €, të gjitha në afat prej 15 dite, pas marrjes së formës së prerë të aktgjykimit, nën kërcënimin e përbërtarit me dhunë.

A r s y e t i m i

I autorizuari i paditëses në fjalën e tij ka dekluaruar mbesë në tërsi padisë dhe kërkesë padisë thënieve të cekura në seancat e kaluara si dhe pranë parashtresës mbi precizimin të dt. dt.14.07.2016, duke shtuar se shumat e kërkuar janë përpiluar duke pasur parasysh pasojet shëndetësore të paditëses, praktikën gjyqësore si dhe satisfaksionin i cili paraqet një kompensim material për këtë të keqe që paditësja ka pësuar.

Njëherit ka shtuar se të paditurat duhet të përgjigjën solidarisht në bazë të nenit 190 al.4 e LMD-së, Meqë paditësja në këtë aksident ka qenë në cilësi të personit të tretë, ndërsa shkaktar dhe kontribuues në shkaktimin e pasojave të këtyre lëndimeve të paditëses janë automjetet e

siguruara të paditurave , andaj meqenëse të paditurat nuk janë pajtuar me rastin e ndarjes së përgjegjësisë, i ka propozuar gjykatës që të aprovohet kërkesë padia e paditëses si e bazuar dhe ti detyroj solidarisht të dy të paditurat që paditëses t'ia kompensojnë dëmin e precizuar.

I ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

I autorizuari i të paditurës së parë në fjalën e tij ka deklaruar mbetem në tërësi pranë përgjigjes në padi, thëniet e cekura në seancat e kaluara, sa i përket bazës juridike ka theksuar se në bazë të ekspertizës të nxjerr në procedurën penale thuhet se deri tek aksidenti ka ardhur si pasojë e lëshimeve të dy pjesëmarrësve në komunikacion, ku lëshimet e përmendura të automjetit B, theksohen se janë 5 lëshime , ndërsa të siguruarit të K.S “ [REDACTED] ” , thuhet se lëshimet e tija nuk kanë ndikuar në shkaktimin e këtij aksidenti , mirëpo kanë ndikuar në dëmet materiale, dhe lidhur me të njëjtën nuk kemi vërejtje, dhe lëshimet e të siguruarit të K.S “[REDACTED] ” janë lëshime sekondare, dhe të njëjtat i ka pranuar si të tilla .

Sa i përket precizimit të kërkesëpadisë, të njëjtën e ka kundërshtuar pjesërisht sa i përket lartësisë, për arsy se shumat e cekura janë shumë të larta dhe iu tejkalojnë kriteret të cilat aplikohen në kompani dhe praktikën gjyqësore.

Njëherit ka shtuar se e paditura duke marr parasysh ekspertizën e komunikacionit bazuar në praktik bartë 20% të përgjegjësisë, si dhe për të njëjtën paditëses i ka ofruar ofertën prej 1.000€, dhe mbi këtë lartësi ka kërkuar nga ana e gjykatës që gjykata ta refuzon kërkesë padinë e paditëses si tepa bazuar.

E autorizuara e të paditurës së dytë në fjalën e tij ka deklaruar mbetët në tërësi pranë përgjigjes në padi thënieve të cekura në seancat e kaluara, duke e kontestuar pjesërisht bazën juridike lartësinë e kërkesëpadisë, pasi që tënëjtit nuk janë harmoni me praktikën gjyqësore, e po ashtu, nuk janë në harmoni me kriteret e kompanive për përcaktimin e lartësisë së dëmit.

Sa i përket bazës juridike ka theksuar se në bazë të ekspertizës së ekspertit të komunikacionit rrugor, konsiderojmë se përgjegjësia civile duhet të jetë 50% me 50%, ku 50% ka kontribut i siguruari tek e paditura e parë ndërsa 50% i siguruari tek e paditura e dytë.

Duke marr parasysh këtë ka theksuar se paditëses ia ofron ofertën në shumë të përgjithshme prej 2.500€, dhe mbi këtë shumë ka kërkuar nga ana e gjykatës që paditëses tia refuzon padinë ndaj të paditurës së dytë si të pa bazuar.

Kurse sa i përket kamatës të kërkuar nga ana e paditëses e ka kundërshtuar pasi që është shumë e lartë dhe e njëjtë është në kundërshtim me dispozitat e LMD-së, kurse në lidhej me kërkesën për shpenzimet e procedurës të cilat i ka kërkuar ia ka propozuar gjykatës që të ketë parasysh suksesin në procedurë.

Gjykata për të vërtetuar gjendjen faktike ka bërë nxjerrjen e provave: Lexohet padia C.nr. 236/15 dt.23.04.2015, autorizimi i paditëses dhënë av. [REDACTED], oferta e të paditurës së parë dt.23.05.2015, raporti i policit hetues nr. Rasti 2014-CFT- 228 dt.14.07.2014, mendimi dhe konstatimi i ekspertit të komunikacionit rrugor dt.02.09.2014 përpiluar nga eksperti [REDACTED] për nevoja të lëndës PP./II.nr.1842-2/2014, fletëlëshimi lëshuar nga Klinika e Kirurgjisë Prishtinë nr. Amëz 5095 dt.22.07 viti i pa lexuar për periudhën 15.07.2014 deri më dt.22.07.2014, fletë lëshimi i Qendrës Emergjente në Ferizaj dt.14.07.2014 nr. Protokolli 6/3, raporti psikiatrik QKMF –Ferizaj dt.25.07.2014, raporti psikiatrik QKMF –Ferizaj dt.05.08.2014, raporti nga QKMF-Ferizaj lëshuar nga Psikologja [REDACTED] dt.08.05.2014, raporti mjekësor lëshuar nga ordinanca " [REDACTED] me nr. Protokolli 901dt.05.08.2014, raporti specialistik lëshuar nga poliklinika "uro-face", dt.24.07.2014, raporti lëshuar nga poliklinika " [REDACTED] me nr. Amëz 8234 dt.26.07.2014, bëhet shiqimi i 9 kuponëve fiskal, parashtresa me emërtim prova shtesë, e paraqitur nga autorizuari i paditëses av. [REDACTED], revokimi i autorizimit paraqitur nga paditësja dt.25.05.2016, përgjigja në padi e të paditurës së parë dt.06.04.2016, përgjigja në padi e të paditurës së dytë dt.30.05.2016, autorizimi i paditëses dhënë av. [REDACTED], autorizimi i të paditurës së parë dhënë përfaqësuesve [REDACTED] dhe [REDACTED], autorizimi i të paditurës së dytë dhënë përfaqësueses [REDACTED] parashtresa mbi precizimi e kërkesëpadisë të bërë nga i autorizuari i paditëses dt.14.07.2016, mendimi dhe konstatimi i ekspertëve të dhënë në seancën e dt.03.06.2016.

Bazuar në provat e administruara dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe të gjitha së bashku, në kuptim të nenit 8 të LPK-së.

Gjykata, në këtë procedurë ka gjetur ndërmjet ndërgjyqësve nuk ishte kontestuese baza juridike e kërkesë padisë, por vetëm ndarja e përgjegjësisë në mes të paditurve nga administrimi i provave, si dhe mendim dhe konstatim i ekspertit të komunikacionit punuar nga [REDACTED] me dt.02.09.2014, është vërtetuar fakti se deri te aksidenti ka ardhur si rezultat i veprimeve të dy palëve të siguruara pranë të paditurve ku lëshime primare te ky aksident ka pasur i siguruari i të paditurës së dytë, me përgjegjësi prej 80%, kurse lëshime sekondare ka pasur i siguruari i të paditurës së parë, me përgjegjësi prej 20% për të cilën gjë sipas detyrimit mbi auto përgjegjësisë ndaj personave të tretë, të paditurat janë të detyruara që solidarisht t'ia shpërblej paditëses në emër të këtyre lëndimeve shpërblimin e dëmit, këtë ndarje të përgjegjësisë gjykata e ka ndarë në bazë të ekspertizës së ekspertit të komunikacionit si dhe sipas bindjes së saj të lirë, pasi që të paditurit nuk kanë mundur të pajtohen në lidhje me përqindjen e të paditurave me në këtë aksident si dhe lartësinë e kërkesë padisë.

Andaj e paditura e dytë është përgjegjëse në shkallë prej 80% për dëmin të cilin i është shkaktuar paditëses, nga fakti se me ekspertizën e ekspertit të komunikacionit deri te shkaktimi i aksidentit ka ardhur duke marr parasysh 5 lëshimet e bëra nga i siguruari i të paditurës së dytë, kurse i siguruari i të paditurës së parë ka bërë 1 lëshim në këtë aksident dhe se veprimet e tij janë vetëm në rritjen e dëmit të shkaktuar në këtë aksident e nuk janë si shkaktar kryesor i shkaktimit të këtij aksidenti andaj gjykata e ka konsideruar se e paditura e parë duhet të bartë 20% të përgjegjësisë.

Në lidhje me këtë gjykata ka konstatuar se në bazë të shkresave të lëndës ekspertizës së ekspertit të komunikacionit thënieve të palëve në procedurë, ekziston lidhja kauzale në mes lartësisë së dëmit të shkaktuar paditëses dhe veprimeve të siguararve të paditurve në këtë aksident.

Gjykata lidhur me lartësinë e dëmit jo material dhe material ka vendosur sipas vlerësimit të lirë në kuptim të nenit 323 LPK-së, dhe në kuptim të dispozitave të neneve 136, 169, 174, 177, 190, dhe 961 të LMD-së, duke u bazuar në mendimin e ekspertëve mjekësor Dr. [REDACTED]

[REDACTED] ortoped dhe Dr. [REDACTED] psikiatër të cilëve gjykata ia ka falur besimin në tërsë, mendimin i cili e ka dhënë në procesverbalin e dt.06.07.2016, si dhe dokumentacionit mjekësor i cili gjendet në shkresat e lëndës të cilat janë administruara si prova në këtë çështje juridike.

Gjykata në emër të dhimbjeve trupore-fizike, ka caktuar lartësinë e shpërblimit në shumë prej 3.000,00 €, kurse e ka refuzuar shumën prej 3.000 euro si teje të lart dhe nuk përkon me lëndimet e pësuara, vendimin e saj e ka bazuar sipas mendimit të ekspertëve mjekësor të dhënë në seancën e dt.06.07.2016 paditësja, në këtë aksident ka pësuar lëndime, ndrydhje të kokës, kraharorit dhe legenit, plagë prerëse dërrmishëse në regjionin zverkur (pjesa e pasme e kokës), plagë prerëse dërrmishëse në regjionin e vetullës së majtë dhe rreth orbitës së syrit të majtë e shoqëruar me gjak mbledhje në kapakun e syrit dhe në regjionin e mollëzës së majtë, thyerje të kockës së mollëzës së majtë, e mbushur me trupa të huaj (gjama), plagë prerëse dërrmishëse nëkrahun e djathët të nën nofullës, plagë prerëse në regjionin për rreth zorrës së trashë me shkolitje të lëkurës dhe gërvishtje të të dy të ndjenjurave, lëndim i muskulit shtrëngues të brendshëm të zorrës së trashë (anulit) të cilat lëndime kualifikohen si lëndime të rënda trupore

Nga lëndimet e marra të sipër theksuara paditësja ka pasur dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë në kohëzgjatje prej 30 min kohë e nevojshme nga momenti i aksidentit, transportit, procedura sdiagnostikuese deri në fillim të mjekimit, pastaj kanë kaluar në dhimbje të intensitetit të rëndë në kohëzgjatje prej 5 ditë, kohë pas kohe deri në marrjen e terapisë kundër dhimbjeve, dhimbje fizike të intensitetit të mesëm 4 javë, kohë e nevojshme për konsuludim kockar të kockës së mollëzës së majtë dhe shërimin parësor të plagëve në zorrën e trashë(anus), dhimbje fizike të intensitetit të ulët të cilat ekzistojnë edhe sot e kësaj dite në formë të dhimbjeve prerëse të barkut për shkak të kapsëllëkut (paditësja referon se del jashtë për nevoja të mëdha një here në 14-15 ditë, në ambient me pluhur i loton syri i majtë, në ndërrim temperaturash i shfyqen dhimbje në fytyrë dhe në vrajat e mbeturë nga plagët.

Për frikën e pësuar gjykata ka caktuar shumën prej 2.300.00€, ndërsa e ka refuzuar shumën prej 2.200.00€, si shumë të lart dhe e cila tejkalon qëllimin e shpërblimit të dëmit, duke u bazuar në mendimin e ekspertëve mjekësor, frika është manifestuar si frikë primare në momentin e aksidentit në formë frike nga vdekja dhe kërcënimi i drejtpërdrejtë për integritet të saj fizik e cila ka zgjatur disa sekonda pastaj ka kaluar në frik sekondare e intensitetit të lartë në kohëzgjatje prej 5 ditë, e cila është manifestuar me çrrëgullim të stresit akut, gjendje ankthi, çrrëgullim gjumi, frikë nga invaliditeti i përhershëm me vështirësi të theksuar me kushtet e trajtimit mjekësor hospitalor duke marr parasysh natyrën e rëndë të lëndimit, frikë të intensitetit të mesëm në kohëzgjatje prej 1 mauj, e cila frikë është manifestuar me brengën dhe frikën e

invaliditetit të përhershëm, zgjimeve të shpeshta gjatë gjumit me ankthe, reagime të natyrës emocionale me të quajtura, depresion aktiv me ëndrra të këqija që kanë shoqëruar periudhën e rehabilitimit dhe trajtimi të pasojave të lëndimit fizik të paditëses, pas kësaj periudhe ka kaluar në frikë sekondare të intensitetit të ulët e cila është prezantë herë pas here e shoqëruar fillimisht me rikujtime të shpeshta të ngjarjes traumatike, rënjes së disponimit të vullnetit, vështërësive të theksuara të ballafaqimit me pasojat e rëndimit të rëndë fizik në pjesë të ndryshme trupore, rënje e konceptimit me harresë të herë pas e hershme e cila ka ndikuar në dëmtimin e ekuilibrit, dhe dinamikës spikike të personalitetit të paditëses.

Paditësi në emër të shëmtim trupor, ka caktuar lartasin e shpërblimit në shumë prej 2.900, kurse shumën prej 3.100 euro e ka refuzuar si të lart, i cili shëmtim përshkruhet si shëmtim në shkallë të mesme për shkak të vrajave, për gjatë vetullës së majtë me gjatësi prej 3cm, cepit të syrit të majtë 1cm, nënkrahun e djathtë të nofullës 1.5cm, kërcirit të majtë 3cm, vraja të radhitura njëra pas tjetrës, me gjatësi prej 6cm, 1cm dhe 4cm, dhe shpinën e dorës së majtë 3 vrajame gjatësi 2 dhe 1.5 cm dhe 1cm, këtë duke marr parasysh gjithnjë edhe moshën e saj.

Gjkata në rastin e aprovimit e kërkesëpadisë sa i përket kërkesës për zvogëlim të aktivitetit jetësor ka aprovuar shumën prej 6.500.00€, ndërsa ka refuzuar shumën prej 5.500.00€, duke vlerësuar se shuma e aprovuar është në përputhje me zvogëlimin e pësuar të aktivitetit jetësor prej 20%, për shkak të deformimit në shkallë të lehtë të mollëzës së fytyrës së majtë dhe lëndimit të zorrës së trashë e cila është dashur të qepet ndërsa shuma e refuzuar është konsideruar si tepër e lartë dhe tejkalon qëllimin e shpërblimit të dëmit në rastin konkret, këtë duke marr parasysh gjithnjë edhe moshën e saj.

Gjkata me rastin e vendosjes për kujdesin nga personi i tretë duke aprovuar kërkesën në shumën prej 100€ dhe atë duke u bazuar mendimin e ekspertëve mjekësor se ndihma dhe kujdesi i personit të tretë për paditësen ka qenë e nevojshme për 30 ditë, e cila është shumë reale me standardin e tanishëm të jetës.

Gjkata me rastin e vendosjes për ushqimin e përforcuar ka aprovuar shumën prej 200.00€, duke vlerësuar se në bazë të vlerësimeve të ekspertëve paditësja ka pas nevojë për ushqim të sforcuar në kohëzgjatje prej 50 ditësh, që në rastin konkret gjykata ka vlerësuar se shuma e aprovuar është reale me kërkuesat e një personi.

Gjykata ka aprovuar kërkesën e paditësit për shpenzimet e shërimit klimatik terapisë fizikale në shumë prej 163.00€, pasi në bazë të mendimit të ekspertëve- ka pas nevojë për terapi fizikale, 30 ditë brenda dy viteve 20 ditë në vitin e parë, dhe 10 ditë në vitin e dytë.

Gjykata konsideron se lartësitë e aprovuar në emër të shpërbimit të dëmit jo-material dhe material është shpërblim i drejtë e të cilat paraqesin një formë të satisfacionit që paditësja me këto mjete të plotësoj nevojat dhe të mirat materiale të dëmtuara që përndryshe nuk paraqesin si shpërblim absolut të dëmit.

Gjykata ka vlerësuar edhe kundërshtimet e përfaqësuesit të paditurve në lidhje me përqindjen e përgjegjësisë për të cilën sipas bindjes së lirë ka vendosur se e paditura e parë ka 20% kurse e paditura e dytë 80%, si dhe vërejtjet në lidhje me lartësinë e kërkesë padisë së paditëses të cilat gjykata konsideroj se janë pjesërisht të bazuara dhe i ka marr parasysh me rastin e vendosjes.

Gjykata në lartësinë e aprovuar të shpërbimit të dëmit jo-material dhe material, paditëses ja ka njojur të drejtën në kamatë ligjore prej 8 %, prej datës. 19.09.2016, deri në pagesën definitive në kuptim të nenit 382 të LMD-së.

Vendimin për shpenzimet e procedurës, gjykata e ka bazuar në kuptim të nenit 452.1 lidhur me nenin 463 të LPK-së, andaj e paditura obligohet të paguaj 1.469.20€ dhe atë 208€ përpilim të padisë, për tri nga 270,40€, përfaqësime në seanca shumën e tërësishme prej 811,20€, për ekspertiza mjekësore shumën prej 300€, dhe për taksë gjyqësore për padi në shumë prej 75€ kurse për aktgjykim shumën prej 75€ të specifikuara me anë të parashtresës

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të aktgjykit.




GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

C.nr.236/15, dt.19.09.2016

- Ac nr. 4511/2016

Gjyqtari
Alban Beqiri



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa për afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes në dorëzim, Gjykates së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.